



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 63, datë 22/12/2004

**“MBI KALIMIN KAPITAL TË INVENTARIT  
PËR VLERAT HISTORIKE TË SEKTORIT TË MUZEVE”**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ligjit Nr.6942, dt.25/12/1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare”, ligjit Nr.7661, dt. 19/01/1993 “Për kontabilitetin”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.153, dt.03/04/1993 “Për kalimin kapital të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore” pika 2/ç, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I;**

1. Të bëhet kalimi kapital i inventarit për objektet me vlerat historike dhe të kulturës popullore të Sektorit të Muzeve në vlefën **79.210 lekë**, sipas fletëve të inventarit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Drejtoria e Financës për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**LUAN SHAHOLLARI**